



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 29.05.2025

Nr.09/ 3873 /2025

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-25-3408-2-3-6/C637 & KKHE-25-019-2-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

4ING SH.P.K., p.n., PODUJEVË-PAKASHTICË E POSHTEME, 810776114, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Lyerja e Zyrave të Qendres për Shërbim me Qytetar (QSHQ-së) me numër identifikues: 659-25-3408-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Lyerja e zyrave të QSHQ-se Demolimi Renovimi i Zyreve Punët e Pastrimi

No.	
1	Lyerja e Zyrave të Qendres për Shërbim me Qytetar (QSHQ-së)

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 2,899.00 €; [Dymijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro /00 cent] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borbh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.-
Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej katërdhjetë (40) diteve respektivisht nga dt.30.05.2025-09.07.2025

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të kushtesë tenderi].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4**Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Xhevdet Bashi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	29/05/2025
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve 4ING SH.P.K.

Emri:	Shpetim Kajtazi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	29/05/2025
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-3408-2-3-6/C637

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës në shërbimet kurseve të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Të shumtën e tyre ato jo janë relevante.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amendamentet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 30.05.2025.
	6.4	Data e Përfundimit është 09.07.2025.
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është Zyra e Qendres për shërbime të përbashkëta në objektin e administratës komunale të Komunës Hanit të Elezit.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është do të caktohet me vendim të veçantë të AK.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% në ditë për shërbimet-punet e parealizuara. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% e vlerës së kontratës të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës me afat prej 90 ditëve apo 3 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë shëno shumën / b) Përgjegjësia e Palës së Tretë shëno shumën / c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve shëno shumën / d) Përgjegjësia profesionale shëno shumën / e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës shëno shumën /
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pas realizimit të shërbimit kryesor të projektit dhe pranimit nga AK. Pagesa do të bëhet brenda afati ligjor pas pranimit të projektit-pranimit të situacioni të punimeve dhe leshimit fatures per pages.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Në aspektin teknik menaxheri i kontratës do të përcaktojë cilësinë e realizimit të shërbimit-punës të bërjes së punës. Periudha Garantuere e Defekteve është Garancioni i kualitetit të punimeve 17 muaj apo 1 vit nga koha e pranimit të projektit nga AK.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit të Elezit ose permes procedurave alternative të zgjidhje se mosmarrëveshjeve-procedurat e ndërmjetesimit me pajtimin e të dy palëve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale në Prishtinë në pajtim me Ligjin e Kosovës ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të specifikuar organit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në pajtim me specifikat rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Kombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbledhjen e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht).